



KARTELA SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Protokolluar me Nr. 114/3 Mbërritur më datë 29.03.2023

Dërgohet nga: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm

Me Nr. Prot. 2538/3 datë 28.03.2023

Përmbledhje e çështjes: Dërgohet Raporti i Auditimit

Në vëmendje: Zyra e Financës, Zyra Juridike


Me porosi: Pas ndjekjes e rekomandimeve
informacion periodik

Dosja u dha më datë 29.3.2023

ADMINISTRATORI

ILIR BANUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 2538/Prot.

Tiranë, më 28. 03. 2023

Lënda: Dërgohet Raporti i Auditimit

“PORTI DETAR” SH.A

VLORE

Bazuar në Ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.100, datë 25.10.2016, si dhe në zbatim të Program Angazhimit të Auditimit me nr.2538/2, datë 07.03.2023, u krye angazhimi i auditimit në shoqërinë “Porti Detar” sh.a, për verifikimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm

Në përfundim të auditimit, grupi i auditimit përgatiti Raportin e Auditimit, me objekt “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm”.

Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të pikës 4.1.13.1 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, dërgohet bashkëlidhur Raporti i Auditimit, mbi auditimin e kryer në subjektin “Porti Detar” sh.a.


Përsa sipër, në zbatim të nenit 12, germa “d” të Ligjit 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, pikës 4.1.13.1 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” dhe pikës 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësive për të zbatuar rekomandimet e AB”, të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, stafi menaxherial të marrë masa për:

1. Ndjekjen dhe realizimin e rekomandimit në proces.
2. Informimin e DAB në MIE në lidhje me zbatimin e rekomandimit të auditimit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

DREJTORI

LIRIM SULEAJ



RAPORT AUDITIMI
MBI
ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE NË “PORTI DETAR” SHA, VLORË

I. Përmbledhje ekzekutive.

Në mbështetje të nenit 14, të Ligjit Nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, të Programit të Auditimit të miratuar me shkresën nr.2538/2, datë 07.03.2023, u krye auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm me shkresën nr. 3836/5 datë 10.08.2022, në “Porti Detar” sha, Vlorë.

“Porti Detar” sha, Vlorë është audituar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për periudhën 01.10.2020–31.12.2021, sipas Programit të Auditimit, miratuar me shkresën nr.3836/2 datë 06.06.2022.

Në përfundim të auditimit, grupi i auditimit ka dërguar Raportin Final të Auditimit, me shkresën Nr. 3865/5 prot, datë 10.08.2022 dhe ka lënë 2 (dy) rekomandime.

Nga “Porti Detar” sha, Vlorë nuk është respektuar afati 30 ditor, sipas përcaktimeve të nenit 12, gërma “d” të Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe nuk është hartuar plani i masave për realizimin e rekomandimeve.

Grupi i auditimit konstatoi se: Nga shoqëria “Porti Detar” sha, Vlorë, janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve duke realizuar 1 prej tyre ose në masën 50%, ndërsa rekomandimi i cili është në proces megjithë masat e marra nga shoqëria realizimi i tij ka lidhje me veprime apo mosveprimet e palëve të treta, si Organet Tatimore apo subjekte juridikë.

Grupi i auditimit paraqet opinionin për vlerësimin e *riskut në nivel të mesëm*.

II. Hyrje

Auditimi ka për qëllim vlerësimin nëse janë marrë në konsideratë dhe realizuar rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm, për përmirësimin e menaxhimit në të gjitha nivelet.

Auditimi u krye mbështetur në dispozitat ligjore, për sa më poshtë vijon:

- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm në Sektorin Publik”.

Auditimi u krye nga grupi i punës i përbërë nga:

1. Merita Gjoka - përgjegjës grupi;
2. Arsemin Leskoviku - anëtare.

Afati i auditimit: 07.03.2023 – 17.03.2023

III. Metoda e auditimit

Metoda e përdorur është ajo e leximit dhe studimit të raporteve të auditimit të mëparshëm, shqyrtimi i dokumentave justifikuese që kanë shoqëruar realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Në përfundim të misionit të auditimit, mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga vlerësimi nëse janë marrë në konsideratë dhe realizuar rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm, u hartua Raporti Përfundimtar i Auditimit.

IV. Gjetjet dhe konkluzionet.

Më hollësisht, realizimi i rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit të MIE, me shkresën nr.3836/5 datë 10.08.2022, paraqitet si më poshtë:

Rekomandimi Nr. 1

Të merren masa që në ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave për të gjitha procedurat e prokurimit të jetë pjesë përbërëse edhe punonjësi me përgjegjësi materiale.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Nga verifikimi i disa praktikave të marrjes në dorëzim rezulton që: Në komisionet e ngritura nga Titullari për marrjen në dorëzim të mallrave/ shërbimeve është vendosur edhe punonjësi me përgjegjësi materiale (magazineri). Komisionet janë ngritur për marrjen në dorëzim të cdo blerje apo shërbimi të kryer nga procedurat e prokurimit publik, si:

- Urdhër nr.95, datë 21.10.2022 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve të kancelarisë”;
- Urdhër nr.80, datë 08.09.2022 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve dhe detergjenteve”;
- Urdhër nr.99, datë 27.10.2022 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve për eliminimin e defekteve të tualeteve në godinën e Terminalit të pasagjerëve”;
- Urdhër nr.132, datë 20.12.2022 “Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të uniformave për sigurinë e portit”.

Si përfundim, ky rekomandimi konsiderohet i realizuar.

Rekomandimi Nr. 2

Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative ligjore duke kryer rakordime me organet tatimore si dhe për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet debitoare për shlyerjet dhe sistemimet për gjendjen e debi kredive të trashëguara ndër vite.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

-Në lidhje me gjendjen e debitorëve në shumën 2,796,137 lekë, të cilat janë të trashëguara në vite, të pandryshuar dhe të paanalizuara se çfarë përfaqësojnë, u konstatua se kjo shumë mbetet e pandryshuar.

-Në lidhje me kërkesat për arkëtim nga organet tatimore të trashëguara në vite, të shumës 11,885, 069 lekë, në fund të vitit 2021, e përbërë nga shuma 3,125,924 lekë për tatim fitimi dhe nga shuma 8,759,145 lekë për TVSH, rezulton se:

✓ Për tatimin fitim në shumën 3,125,924 lekë, ka mbetur e pandryshuar pasi bilanci i vitit 2022 nuk është mbyllur dhe është brenda afatit kohor (31 mars), për rrjedhojë nuk është bërë deklarata e tatim fitimit që të ndikojë në ndryshimin e kësaj vlere.

✓ Për rimbursimin e TVSH në shumën 8,759,145 lekë, nga ana e shoqërisë nuk janë bërë rakordime me organet tatimore, por janë përpiluar kërkesa për rimbursim të TVSH sipas shumave të deklarimeve mujore të mëparshme. Këto kërkesa janë bërë më datë 16.02.2023, dhe deri më datën e hartimit të këtij materiali nuk ka përgjigje nga Organet Tatimore, pasi është brenda afatit kohor 30 ditor.

Si përfundim, ky rekomandim konsiderohet në proces.

V. Rekomandimet e auditimit.

Në përfundim, Grupi i Auditimit për ecurinë e realizimin e rekomandimit të lënë, sugjeron:

- a) ndjekjen me nje plan pune te detajuar dhe afate aktuale për zbatimin e rekomandimit të evidentuar në proces nga ky auditim.

Nga strukturat menaxhuese në “Porti Vlorë” sh.a, të raportohet periodikisht në DAB ne MIE, për ecurinë e realizimit të rekomandimit të lënë.

VI. Komentet e subjektit të audituar.

Projekt Raportit mbi zbatimin e rekomandimeve është nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë dhe është protokolluar nga subjekti me nr.114/2, datë 10.03.2023.

VII. Falenderime.

Grupi i punës falenderon stafin e “Porti Vlorë” sh.a, për gadishmërinë për vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe bashkëpunimit gjatë gjithë kohës së kryerjes të angazhimit dhe realizimin e këtij misioni auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

Merita GJOKA

Arsemin LESKOVIKU